



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
KOMISIONI I DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT**

Nr. 25/2 Prot.

RHK
Kopje nr.
Tiranë, më 28. 10. 2019

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me Urdhër nr.13, datë 03. 05. 2018, të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e dokumenteve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 25, datë 28. 10. 2019 si më poshtë:

**FONDI ARKIVOR I ISH SIGURIMIT TË SHTETIT
QË ADMINISTROHET NGA AIDSSH**

1. Deklasifikimin plotësisht të Dosje e Problemit të Centralizuar “Dhelpra” nr. 1160, në ngarkim të **A. K. H., A. H. A., A. S. S., E. K. H. dhe P. K. H.**, me 244 (dyqind e dyzetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
2. Deklasifikimin plotësisht të Dosje e Problemit të Centralizuar “Korbat” nr. 1162, në ngarkim të **Familjes P., (M. P., E. P., R. P., P. P., A. P., N. P., I. P., N. P., T. P., E. P., Zh. P.)**, me 9 volume me 2221 (dymijë e dyqind e njëzetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
3. Deklasifikimin plotësisht të Dosje Objekti nr. 206, në ngarkim të qytetarëve shqiptarë që u larguan nëpërmjet ambasadës gjermane për në RFGJ, me 335 (treqind e tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e II-të.
4. Deklasifikimin plotësisht të Dosje Objekti nr. 207, në ngarkim të qytetarëve shqiptarë që u larguan nëpërmjet ambasadës franceze për në Francë, me 232 (dyqind e tridhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e II-të.
5. Deklasifikimin plotësisht të Fashikull per futjen e disa personave në ambasadën greke dhe italiane 2 Korrik 1990, me 78 (shtatëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e II-të.

6. Deklasifikimin plotësisht të Dosar nr. 1, “Informacione dhe lista të degëve për personat e futur në ambasada”, me 137(njëqind e tridhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e II-të.
7. Deklasifikimin pjesërisht të Fletë rregjistri i agjencurës model 2, të dhënat që i përkasin numrit rendor 3487, në ngarkim të **D. I. K.**, pseudonimi “heshtja”. Niveli i klasifikimit “sekret”.
8. Deklasifikimin pjesërisht të Fletë regjistri “Libri i Fondit Sekret (Fondi veçantë)”, të dhënat që i përkasin numrit rendor 7, në ngarkim të **L. H. M.**. Niveli i klasifikimit “sekret i rëndësisë së veçantë”.

KRYETARLI KDZH

Gentiana Sula

